



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilaški Savet Kosova/ Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4. Paragrafi 1.27 të Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 83 publikuar me dt. 29 tetor 2010) dhe të nenit 5 paragrafi 1.1, të Ligji Nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 17 publikuar me 30 qershor 2015, në mbledhjen e mbajtur me 01 dhjetor 2015, miraton:

R R E G U L L O R E NR.08/2015

PËR KOMISIONIN PËR ÇËSHTJE NORMATIVE

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë organizimin e punës dhe përgjegjësitë e Komisionit për Çështje Normative, si komision i përhershëm që shqyrton bazën juridike për të gjitha rregulloret dhe aktet tjera të miratuara në Këshillin Prokurorial të Kosovës përkitazi se a janë në harmoni dhe pajtueshmeri me Kushtetutën, ligjet në fuqi dhe rregulloret ekzistuese të KPK-së.

Neni 2
Fushëveprimi

Fushëveprimi i kësaj Rregullore është procedimi i rekomandimeve përfundimtare në KPK që lidhen me çështjet që i janë ngarkuar komisionit.

Neni 3
Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

"KPK"Këshilli Prokurorial i Kosovës.

"Komisioni" ... Komisioni për Çështje Normative

"Ligji" Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Neni 4

Përgjegjësitë e Komisionit

4.1 Komisioni për Çështje Normative, si komision i përhershëm është përgjegjës që:

- 4.1.1 Të shqyrtojë bazën juridike për aktet nënligjore dhe dokumentet tjera normative, para miratimit të tyre në Këshill, përkatësisht a janë në pajtueshmëri me Kushtetutën, ligjet në fuqi dhe rregulloret ekzistuese të Këshillit;
- 4.1.2 Të analizojë dhe vlerësojë përshtatshmërinë e akteve nënligjore ekzistuese për funksionimin e Këshillit dhe prokurorive;
- 4.1.3 Të shqyrtojë dhe përgatisë rekomandime për ndryshimin dhe plotësimin e rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe dukumenteve të tjera para se dërgohen në Këshill për miratim;
- 4.1.4 Të shqyrtoj çështjet që lidhen me metodologjinë dhe me teknikën unike të hartimit të akteve nënligjore;
- 4.1.5 Të mbikëqyrë zbatimin e akteve nënligjore;
- 4.1.6 Të shqyrtojë çështjet e tjera të përcaktuara me këtë Rregullore dhe çështjet të cilat me vendim të veçantë nga Këshilli, i barten këtij Komisioni;
- 4.1.7 Të angazhojë ekspertë sipas nevojës, për çështje të caktuara në fushëveprimin e komisionit me miratimin e Këshillit;
- 4.1.8 Të organizojë dëgjime publike për çështje të caktuara gjatë hartimit të akteve nënligjore;
- 4.1.9 Komisioni kontakton me komisionet e tjera të Këshillit për t'i harmonizuar dhe unifikuar procedurat e punës dhe organizimit të tyre.

Neni 5

Përbërja e Komisionit dhe mandati

5.1 Këshilli merr vendim për zgjedhjen anëtarëve të Komisionit. Numri i anëtarëve nuk mund të jetë më pak se tre dhe mandati i tyre është 5 (pesë) vjeçar.

5.2 Kryesuesi i Komisionit zgjidhet nga radha e anëtarëve të Këshillit, ndërsa anëtar të Komisionit mund të jenë edhe prokurorët.

5.3 Anëtarët e Komisionit nuk mund të jenë njëkohësisht anëtarë edhe në komisionet tjera të përhershme të Këshillit.

Neni 6

Përgjegjësitë e kryesuesit të Komisionit

6.1 Kryesuesi i Komisionit, përveç tjerash ka edhe këto kompetenca:

- 6.1.1 organizon punën e përgjithshme të Komisionit;
- 6.1.2 përgjigjet para Këshillit për veprimtarinë e Komisionit;
- 6.1.3 autorizon anëtarët dhe sekretarin për ushtrimin e detyrave;
- 6.1.4 nënshkruan vendime, akte dhe shkresa të tjera;
- 6.1.5 planifikon programin e punës;
- 6.1.6 thërret mbledhjet dhe i udhëheq ato;
- 6.1.7 çdo 6 muaj përgatit raport mbi punën e komisionit;
- 6.1.8 përgatit raportin vjetor me komisionin dhe ia paraqet Këshillit për aprovim;
- 6.1.9 kryen punë të tjera të përcaktuara me Ligj, Rregullore dhe sipas kërkesës së Këshillit/ Kryesuesit të Këshillit.
- 6.1.10 në rast se kryesuesi i Komisionit është i penguar ta kryej detyrën, anëtari-prokuror i Komisionit e ushtron detyrën e tij deri sa të shmanget një pengësë e tillë.

Neni 7

Mbledhjet e Komisionit

7.1 Mbledhjet e komisionit thirren nga kryesuesi i Komisionit, sipas planit vjetor të punës të miratuar nga ana e tij. Kryesuesi i Komisionit mund të bëjë thirrje për takime të jashtëzakonshme.

7.2 Në mungesë të Kryesuesit të Komisionit mbledhjen e thërret njëri nga anëtarët e komisionit i caktuar nga ana e tij.

7.3 Kryesuesi i Komisionit ose njëri nga anëtarët e tij, mund ta thërret mbledhjen e komisionit për një datë tjetër më të përshtatshme, nëse e kërkon Këshilli.

7.4 Datën dhe rendin e ditës e cakton kryesusi ose njëri nga anëtarët e Komisionit me autorizim të tij, përveç nëse komisioni më parë ka vendos ndryshe. Me rendin e ditës anëtarët e komisionit njoftohen jo më vonë se tre ditë pune para se të mbahet mbledhja. Rendi i ditës mund të ndryshojë vetëm me vendim të komisionit.

7.5 Komisioni mund të ftoj ekspert të jashtëm për ta mbështetur punën e Komisionit. Nëse kërkohet kompensim nga ana e tyre, Këshilli me vendim e përcakton shumën e kompensimit.

7.6 Komisioni mbledhet sipas nevojës, por jo më pak se një herë në muaj.

Neni 8

Natyra e takimeve të komisionit

8.1 Mbledhjet e komisioneve, në parim, janë të hapura, përveç në rastet kur komisioni diskuton çështje konfidenciale të parapara me ligj apo rregullore të Këshillit.

8.2 Secili anëtar i Këshillit mund të marrë pjesë në mbledhjet e komisionit tek i cili ai nuk është anëtar, por pa të drejtë vote.

8.3 Komisioni mund të ftojë në mbledhje përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare si dhe shoqërisë civile për të paraqitur rekomandime apo dokumente të rëndësishme.

8.4 Komisioni mund të organizoj edhe dëgjime publike me qëllim të diskutoj gjërsisht me grupe tjera çështjet që janë në shqyrtim.

Neni 9

Raportet e Komisionit

9.1 Kryesuesi në emër të Komisionit përgatitë raport me shkrim për KPK-në. Raporti i Komisionit mund të plotësohet edhe me gojë nga kryesusi apo anëtari raportues i Komisionit.

9.2 Raporti i Komisionit duhet të përmbajë rekomandimet bashkë me arsyetimin përkatës. Raporti mund të paraqet si njoftim edhe arsyet dhe opinionet e kundërta.

9.3 Komisioni në përfundim të vitit kalendarik e njofton Këshillin me raport për punën e tij njëvjeçare. Raporti do të përfshijë veprimtarinë e Komisionit.

Neni 10

Nënkomisionet

10.1 Komisioni për punë dhe detyra specifike, mund t'i propozojë Këshillit të formojë nën-komisione. Për formimin e nën-komisionit dhe përbërjen e tij, vendimin përfundimtar e merr Këshilli.

10.2 Njëri nga anëtarët e Komisionit duhet të jetë kryesues i nënkomisionit.

10.3 Nënkomisioni për punën e vetë i raporton Komisionit.

Neni 11

Procedura e votimit në Komision

11.1 Komisioni të gjitha vendimet i merrë me shumicën e votave. Në të njëjtën mënyrë vendimet i merrë edhe nënkomisioni.

11.2 Në procesverbal shënohet mendimi i kundërt i ndonjërit anëtarë.

11.3 Procesverbalin e nënshkruan kryesuesi i Komisionit.

11.4 Kryesusi sipas detyrës zyrtare, apo me kërkesë të ndonjërit anëtarë të komisionit apo pjesmarrësve tjerë mund ti korigjojë gabimet eventuale në procesverbal apo në vendime tjera.

Neni 12

Mbështetja administrative

12.1 Sekretariati i Këshilli ofron mbështetje administrative për Komisionin dhe ndërmerr detyra dhe autorizime të tjera sipas nevojës dhe udhëzimeve të Këshillit.

12.2 Sekretariati mban regjistër me të dhëna për të gjitha aktet e diskutuara dhe shqyrtuara në Komision si dhe të miratuara në Këshill.

Neni 13 Kompensimi

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre kanë të drejtë në kompensim. Mënyren dhe shumën e kompensimit e cakton Këshilli me vendim.

Neni 14 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Prishtinë, më 01 dhjetor 2015

Këshilli Prokurorial i Kosovës

Kryesues Aleksandër Lumezi

